

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-217/14

Prishtinë

5 Tetor 2016

Në çështjen juridike të:

B.Z. ,

Nga Gjakova i përfaqësuar nga

I.O., avokat nga Deçani

Pala ankuese

kundër

I.V.N.

Pakovraça 32

Çaçak

Serbi

Kërkuesja -Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtaret: Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Anna Bednarek dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/206/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin (KPA16520) të datës 11.6.2014), pas shqyrtimit të mbajtur më 5 Tetor 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM:

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e B.Z. i përfaqësuar nga Avokati I.O. , naga Deçani i paraqitur kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/206/2013 i datës 11.6.2013, për sa i përket kërkesës të regjistruar në KPCC nr. 16520**
- 2. Konfirmohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/206/2013 i datës 11.6.2013 për sa i përket kërkesës të regjistruar në KPCC nr. 16520**

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. I.N. ka paraqitur një kërkesë si titullar i drejtës pronësore me të cilën ka kërkuar të drejtën pronësore në ngastrës 182 që gjendet në zonën kadastrale Strelcë i poshtëm ,Komuna e Deçanit si dh shtëpisë të ndërtuar në këtë ngastër me sipërfaqe prej 90m² në vitin 1949. Ajo thekson se banesën e ka humbur për shkak të konfliktit të armatosur në periudhën 1998/99, duke cekur datën 13.6.1999 si datën e humbjes. Kërkesa është regjistruar në AKP me numrin KPA16520.
2. Për ta mbështetur kërkesën e saj, pala ankuese ka dorëzuar këto dokumente:

-fletën poseduese nr.384 të datës 20.3.2008,të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi ,Pronësi të Komunës së Deçanit. Sipas kësaj flete poseduese konstatohet se ngastra kadastrale nr. 182 që gjendet në vendin e quajtur “Zlapek-Lugi i Locit” me kulturë pemishte e klasit të II-të shtëpi, ndërtesë, dhe oborr në sipërfaqe prej 0.58.74 ha e cila është e regjistruar në emër të paraqitëses së kërkesës;

- certifikatën mbi të drejtën e pronës së paluajtshme UL-70511022-00384 të datës 8.1.2013, ku konstatohet se ngastra kadastrale 182 në sipërfaqe prej 5874 m2 është e regjistruar në emër të I.N. përkatësisht në emër të paraqitëses së kërkesës
3. Dokumentet e mësipërme sipas raportit të verifikimit të AKP të datës 20.3.2008 dhe 18.1.2013 janë verifikuar pozitivisht.
 4. Prona që është objekt i kërkesës është notifikuar më datë 4 shkurt 2009 dhe me 30 mars 2010. E njëjta pronë është konstatuar se është uzurpuar nga pala përgjegjëse në kërkesë, i cili ka pretenduar të drejtën ligjore në pronën e kërkuar.
 5. Për të mbështetur kërkesën e tij ai ka paraqitur procesverbalin e Komisionit të Qarkut Agrarë nga Peja e datës 6 janar 1926 të lëshuar nga Ministria për Reformën Agrare të Mbretërisë Serbe, Kroate dhe Sllovene nr. 928 të datës 4 prill 1928 si dhe disa shkresa të drejtuar organeve partiake të asaj kohe si dhe përgjigjet e atyre organeve me të cilët ato kërkesa dhe ankesa janë përcjellë Komitetit Komunal të LSPP në Deçan për verifikim dhe veprim.
 6. Sipas raportit të verifikimit të Agjencisë Kosovare të Pronave të datës 20.3.2008 procesverbale i Ministrisë për Reforma Agrare të Mbretërisë Serbe, Kroate dhe Sllovene nr. 928 i datës 4 prill 1928 të vërtetuar më datë 9.7.1969 nuk është gjetur nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi të Komunës së Deçanit.
 7. Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin e saj KPCC/D/R/206/2013 i datës 11.6.2013 ka pranuar kërkesën e I.V.N., duke konstatuar se ajo e ka të drejtën e posedimit të pronës në fjalë dhe se e njëjta është pronare e ngastrës kadastrale nr. 182 të regjistruar në f. poseduese nr. 382 që gjendet në z.k. Strellc i Epërm, Komuna e Deçanit me sipërfaqe prej 0.58.74 ha.
 8. Në arsyetimin e vendimit ankimor konstatohet se paraqitësja e kërkesës duke paraqitur fletën poseduese dhe certifikatën mbi të drejtën e pronës së paluajtshme me pa mëdyshje dhe në mënyrë të sigurve ka vërtetuar se ajo është pronare e ligjshme e pronës së kërkuar, ndaj edhe i pranohet ajo cilësi duke vërtetuar pronësinë mbi këtë pronë që është objekt i kërkesës. Ndërkaq, pala përgjegjëse ndonëse kërkon të drejtën ligjore për pronat e kërkuara sipas kërkesës nr. 16520, duke paraqitur aktvendimin e Ministrisë për Reformën Agrare të Mbretërisë Serbe, Kroate dhe Sllovene nr. 928 i datës 4 prill 1928 në Beograd si dhe padinë për vërtetimin e të drejtës së pronës në Gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Deçan, C.nr.89/2014 me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet e drejta e pronësisë të ngastrës që është objekt i kësaj kërkesë, por këto prova nuk janë prova juridikisht të vlefshme për ta vërtetuar të drejtën pronës që janë objekt i

kësaj çështje juridike-detyrmore. Komisioni konkludon se këto dokumente jo vetëm që nuk kanë mundur të verifikohen si pozitive por që të njëjtat nuk përfaqësojnë prova juridikisht të vlefshme për të vërtetuar pretendimet e tij për pronën që është objekt i kërkesës, prandaj edhe ka përfunduar se paraqitësja e kërkesës ka vërtetuar tërësisht dhe saktësisht se ka të drejtën në pronën që është objekt i kësaj kërkesë.

9. Vendimi i është dorëzua palës ankuese më datë 10.6.2014 kurse ka paraqitur ankesë më datë 17.6.2014. Paraqitësit të kërkesës vendimi i është dorëzuar më 3.6.2014 dhe se e njëjta ka paraqitur përgjigje në ankesë më datë 26.11.2014.

Pretendimet e palëve

10. Pala ankuese, B.Z., përmes përfaqësuesit të tij I.D., av. nga Deçani, pretendon se vendimi ankimor i KPCC-së është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të LPK, zbatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikim të gabuar të së drejtës materiale si dhe për shkak të aplikimit të gabuar urdhrit të theksuar në vendimin ankimor, me kërkesë që të pranohet ankesa e tij dhe të prishet vendimi ankimor dhe e njëjta t'i dërgohet Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan, si gjykatë kompetente lëndore dhe vendore. Pala ankuese pretendon se pronat e kërkuara i ishin marrë stërgjyshit të tij në mënyrë të paligjshme gjatë reformës agrare pas luftës së I-rë botërore dhe se në asnjë fazë të mëvonshme nuk i është kthyer e drejta pronësore që është objekt i kërkesës. Për të mbështetur kërkesën e tyre ankuesi ka paraqitur aktvendimin e Ministrisë për Reformë Agrare të Mbretërisë, Serbe, Kroate dhe Sllovene nr. 928 i datës 4 prill 1928. Po kështu paraqitësi i ankesës ka paraqitur një padi në gjykatën Komunale në Deçan me datë 16 qershor 2014 duke kërkuar prej asaj Gjykate që të vërtetohet e drejta e pronës e ngastrës kadastrale nr. 182.

Pala përgjegjëse në ankesë me parashtresën e datës 26.11.2014,pretendon se vendimi ankimor është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se paraqitësi i ankesës nuk ka paraqitur asnjë fakt juridikisht të vlefshëm dhe nuk ka propozuar asnjë provë relevante që vërtetojnë të drejtën e pronës që është objekt i kërkesës. Pala përgjegjëse në ankesë matej deklaron se,nga viti 1919 e deri me rastin e largimit nga Kosova më datë 13.6.1999 në vazhdimësi ka qenë në posedim dhe në shfrytëzim të ngastrës kadastrale të kërkuar. Pala përgjegjëse në ankesë thekson se,paraqitësja e kërkesës duke propozuar prova juridikisht të vlefshme duke përfshirë f. poseduese nr. 384 të Drejtorisë për Kadastër ,Gjeodezi dhe Pronësi i datës 20.3.2008 dhe Certifikatën mbi të Drejtat e pronës së paluajtshme të datës 13.1.2013,thekson se prona e kërkuar në vazhdimësi ka qenë e regjistruar

në emër të paraqitëses së kërkesës. Nga aktvendimi i Ministrisë për Reformë Agrare i Mbretërisë, Serbe, Kroate dhe Sllovene nr. 928 i datës 4 prill 1928, nuk mund të vërtetohet me saktësi se cila është ajo ngastër kadastrale, nënshkrimi dhe vula e atij aktvendimi si dhe e njëjta është shkruar në alfabetin latin , gjë që për kohën të gjitha shkresat janë shkruar në alfabetin cirilik. Për këto shkaqe dhe arsye i propozon gjykatës që ta vërtetojë vendimin ankimor të KPCC dhe ta refuzojë ankesën e paraqitësit të saj si të pabazuar.

Arsyetim ligjor

Pranueshmëria e ankesës

11. Ankesa është e pranueshme, pasi është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditësh siç parashikohet në nenin 12.1 të Ligjit nr. 03/L-079.

Juridiksioni

12. Gjykata Supreme ka juridiksion për ta shqyrtuar ankesën.

13. Gjykata Supreme pas shqyrtimit të vendimit ankimor, shkresave të lëndës si dhe pretendimeve të theksuara në ankesë sipas dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjeti se:
Ankesa është e pabazuar.

14. Gjykata Supreme vëren se vendimi ankimor i KPCC-së është i drejtë, i plotë , i saktë, i kuptueshëm dhe përfshinë shpjegimin edhe sqarimin e të gjitha fakteve vendimtare për marrjen e një vendimi të ligjshëm. KPCC me vendimin e tij ka bërë vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike mbi bazën e së cilës drejt ka zbatuar edhe të drejtën materiale kur ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paraqitësit të kërkesës për vërtetimin e të drejtës pronësore për ngastrën kadastrale 182 që gjendet në vendin e quajtur “Zlapek-Lugu i Locit” në sipërfaqe prej 5874 m² z.k. Strelc i Epërm , Komuna e Deçanit.

15. Objekti i shqyrtimit dhe të vlerësimit të veçantë të gjykatës ishin edhe pretendimet e ankuesit se pronat e kërkuara i ishin marrë stërgjyshit të tij në mënyrë të paligjshme në kohën e Mbretërisë së Jugosllavisë si pjesë e reformës agrare pas Luftës së I-rë botërore dhe se më vonë nuk i është kthyer e drejta pronësore duke paraqitur aktvendimin administrativ të Ministrisë së Reformës Agrare të Mbretërisë Serbe, Kroate dhe Sllovene nr. 928 datë 4 prill 1928, por gjeti se këto pretendime të tij janë të pabazuara, të papranueshme dhe rrjedhimisht të kundërligjshme. Kjo

pikërisht për arsye se ky aktvendim nuk është verifikuar pozitivisht dhe se i njëjti nuk përcakton jo vetëm ngastrën kadastrale por as që konkretizohet me matje dhe përkufizime të sakta gjeometrike. Përpos kësaj këtij aktvendimi i mungojnë edhe elementet konstituive të tij i cili para se gjithash është paraqitur në fotokopje dhe vende vende i palexueshëm dhe si i tillë nuk është i përshtatshëm për ta mbështetur aktgjykimin në këtë dokument. Përpos kësaj pala përgjegjëse në ankesë duke paraqitur prova juridikisht të vlefshme në radhë të parë fletën poseduese të Drejtorisë për Kadastrë, Gjeodezi dhe Pronësi nr. 384 të datës 20.3.2008 e më vonë edhe Certifikatën mbi të drejtën e pronës së paluajtshme të datës 18.1.2013 me të cilën vërtetohet se paraqitësja e kërkesës – pala përgjegjëse në ankesë e ka fituar pronësinë mbi baza juridikisht të vlefshme sipas dispozitës së nenit 20 të Ligjit themelor nga marrëdhënia pronësore juridike respektivisht të nenit 36 të Ligjit të pronësisë dhe të drejtave tjera sendore.

16. Përpos kësaj me dispozitën e nenit 7 par 2 të Ligjit 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, me të cilën parashikohet se të dhënat e regjistruara certifikatën mbi të drejtën e pronës së paluajtshme UL-70511022-00384 të datës 18.1.2013, të Zyrës Kadastrale në Deçan konstatohet se ngastrat kadastrale 182 në sipërfaqe prej 5874 m² është e regjistruar në emër të I.N. përkatësisht në emër të paraqitëses së kërkesës , ndaj supozohet këto të dhëna janë të sakta, të vërteta, dhe të ligjshme derisa të mos korrigjohen në bazë të procedurave të themeluara me ligj. Prandaj, nëse eventualisht pala ankuese pretendon se regjistri i të drejtës mbi këto prona të paluajtshme në Zyrë Kadastrale në Deçan nuk është i ligjshëm dhe se cenon të drejtat e tij, atëherë ka autorizime dhe përgjegjësi që sipas dispozitës së nenit 5.4 të së njëjtit Ligj të iniciojë procedurë përkatëse gjyqësore për t'i vërtetuar ato pretendime.
17. Objekti i vlerësimit i gjykatës ishte edhe paraqitja e padisë për vërtetimin e të drejtës pronësore në gjykatën Themelore në Pejë-Dega në Deçan por gjeti se sipas nenit 13 par. 6 të Ligjit nr. 03/L-79, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjete juridike të rregullta apo të jashtëzakonshme. Gjykata konkludon se sikundër Komisioni por edhe Gjykata Supreme nuk mund t'i mbështet vendimin e saj për të pranuar kërkesën e paraqitësit të kërkesës mbi bazën e dokumenteve të cilat janë verifikuar negativisht.
18. Objekti i shqyrtimit dhe vlerësimit ishin edhe disa parashtresa tjera tjera të paraqitura nga paraqitësi i kërkesës-ankesës, por të njëjtat nuk ishin me ndikim relevant në marrjen e një vendimi tjetër lidhur me këtë çështje banesore.

19. Rrjedhimisht mbi të mësipërmen , Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja e ka bazuar vendimin ne përcaktimin korrekt dhe te plote te gjendjes faktike dhe ne aplikimin e duhur te ligjit material. Prandaj, Gjykata Supreme arrin ne përfundimin se ankesa është e pabazuar.

20. Në bazë të arsyeve të paraqitura në pajtim me nenin 13.3.c të Ligjit nr. 03/L-079 dhe nenin 200 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, vërtetohet vendimi i KKPK-së dhe refuzohet ankesa si e pabazuar.

Këshillë juridike

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referent i EULEX-it